




BIBLIOTEKA
SHTETIT

JJH-1

H 53



HESHTJA E NJE KOHE



POEZI
NGA
KOSOVA

814-1
H 53

HESHTJA E NJË KOHE

Poezi nga Kosova

29583



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

SHTRYPŞHKRONJA E RE

Tirazhi 1500 kopje

Format 70 x 100/32

Stash: 2204-72

KOMBINATI POLIGRAFIK — Shtypshkronja e Re

Tiranë, 1976

MAZLLUM SANEJA

HESHTJA E NJË KOHE

Heshtjen e një kohe dua ta zgjoj.

Fjalët e shumë këngëve të pashkruara
thellë mbeten në ne
në shpirrat tanë të lindur
dhe në heshtjet e madhërishme.

Një ëndërr e llahtarshme fundoset
në sytë e kaltër të liqenit virgjër,
që unë e përfytyroja ashtu i humbur përines

dritäres

edhe blerimin e shkrumuar
edhe qetësinë e tmerruar
e atëherë, më dukej se ish vjeshtë e sëmurë
vjeshtë e shkretëruar dhe e flijuar para kohe, ah
e përcëlluar nga një dhembje e heshtur
dhembje e përtypur, dhembje e dujgur
e unë doja ta dijë tërë fshehtësinë
e një heshtjeje të një kohe...

Ju thashë, heshtjen e një kohe dua ta zgjoj.

TI, KURÆ: *WILHELM AUF DER HÖH*

Ti kurrë nuk do të dish për dhembjen e fshehur të pranverës.

Ti kurrë nuk do të pa'randjesh për vdekjen e thellë të një vere.

Ti kurre nuk do tē dēgjosh pēr zerin e shurdhēr tē një vjeshte.

Ti s'di tē shijosh magjinë é fshehur në atë varg
në tē cilin është ndryshimri, emri i tij.

G R A N A D A

(Federiko Garsia Lorkes)

Oh, ç'ëshëtë ajo flakë n'Granadë?
Përse s'ndihet kitara?
Ku janë vallet e jevgjëve?

Dy duar të hekurta,
dy duar kasapësh
gjak njeriu kërkuan
gjak poeti fituan.

A vdes Granada?

KËLTHITJE

Thashë: një këngë të pikëlluar
një fëmijë akoma e këndon,
në horizont duket një ylli i ndriçuar
dhe në një thikë gjak pikon.

MALLËNGJIMI

Një natë të ëndërrova
në thikën e dhembjes,
nënë.

Plagët e tua
që prajshëm i bartte
në shpirtin e shtypur,
kur endje pëlhirat e zonjave
në avlëmendin e vjetëruar prej druri
dhe dergeshe nga një mori sëmundjesh,
nënë.

Një natë dëshirova
të të kem pranë,
nënë
se kujtimi yt
më kall shpirtin e mendjen,
o nënë, o nënë...

THJESHTËSI E PASHKRUAR

Thua se kemi parandjerë edhe më parë
se mes nesh do t'lindet për të mbetur përmot
vjershëtori që ndjenjën e ka zjarr
e që pezmin e hidhur në lyrë do t'na thotë

E T J E

Dy duar të padukshme
kaherë grishin dashurinë,
dy duar të padukshme
kaherë kërkojnë bukurinë.

Ç'etje dashuric,
ç'etje bukurie
digjet në shpirtin tim,
o vargu im.

KJO ËSHTË BUKA JONË

Dielli është diell
vetëm kur ka zjarr.

Fjala është fjalë
kur e ka peshën e gurit.

Kënga është këngë
kur matet me dhëmbë e dashuri.

S H P E S H H E R È


Shpeshherë ulem në pluhur
para shtëpisë sime trarënxitra
dhe shkruaj vjersha për tokën,
për blozën, për njeriun tim,
plakun e thimë, punëtorin analfabet,
fshatarin bujar,
që shtron sofrën e varfër para miqve,
thotë: trima, bukë, kripë e zemër,
në shpirt jemi të pasur,
jemi të bardhë.

NJË FSHATAR DUKE LEXUAR NJË LIBËR

Ky është për t'u flakur,
libër biblë.

Këta tinguj nuk rrëfejnë
për sytë e ballit tim.

Nga fillimi gjer në fund
jetë e pajetuar,
të urtë jemi
të urta i duam këngët,
të thjeshtë jemi,
të thjeshta i duam këngët.



LAGJIA

**Lagjia ime e urtë,
lagjia ime e trembur,
po e varros hijen e gjakimit.**

**Fqiu i parë
është dashuruar në fqiu e dytë,
fqiu i tretë e pa këtë bukuri,
fqiu i katërt e ndjeu ngjyrën e gjakut
dhe syrin e dritës.**

**Fqinjtë e mi të urtë
janë kthyer me sy kah dashuria.**

MEHMEDALI HOXHA

NJË BREZ LIVADH

Një brez livadh
edhe një dhi,
ç'kujtime të tjera
t'ju them tani
për fëmijërinë time!...

Sa plaste agimi
dilnim fushës;
bari gjer te sytë
e lulet e fushës
na mbushnin me gëzime.

Dhe të kreshpëruar
këngës ia thonim
me fije mbuluar,
librat ëndërronim,
mullarëve në kërcime.

Të gjitha gëzimet
kështu i festonim,
të gjitha tronditjet
kështu i përjetonim,
në skamje, frikë e dëshpërime...

Një brez livadh
edhe një dhi,
ç'kujtime tjera
t'ju them tani
për fëmijërinë time!...

KOLONA PARTIZANE

Radolishtit tri herë të djugur

Gjarpëronte kolona
e në agim,
me gjak dëshmorësh vaditur,
shpërtheu edhe një kushtrim.

Mbi qafë zgjedha
e paduruar
u bë për ne
e si rrufe
duhej flakëruar
me gjak të shkruar
ashtu si na the.

Gjarpëronte kolona
e në fshatin tim
si valë e dergjur kulçedra
mbolli edhe një trishtim.

Tri herë me radhë
gjaku gërmadhë
u derdh përdhe
e si rrëke
e njomi fushën,
pyllin e fshatin
ashtu si dje.

Gjarpëronte kolona
e në kushtrim
buzë vetullës së shpatit
ngadhnjeu edhe një agim.

Kur fshati, mali
bashkohen tok
e si dy shokë
kërkojnë liri,
s'ka më fuqi
që u del përpara
as dje, as tani.

V E N D L I N D J A I M E

Zemra më gufon
e malli më merr gjithmonë
për fshatin, vatrën, rrugët
në gëzime...
S'ka si rrugica ime!

Gjarpëron ajo
në jetë, në mua, kudo
dhe zbuluron fshatin e vuajtur
në ngadhnjim...
S'ka si fshati im.

Të ec rrugëve
me shelgje stolisur, urave
që krojet e përshkojnë plot jetë
e kujtime
s'ka si vendlindja ime.

Rrugëve, po
ku kam luajtur si fëmi'
dhe kam bërë ndonjë marrëzi
të shkoj të bredh
në dëfrime...
Vërtet, s'ka si vendlindja ime!

NJË MAJIT

Brohoritni
duarlart sa jeni
dhe shikoni
lulkuqen ta keni
në shtëpi.

Ajo ditë
duhet kujtuar
gjaku pikuar
e njomi dhenë
që zogu i vogël
krahëhapur
ta ketë folënë
me stoli.

Këndoni
zemër plot ku jeni
dhe kërkoni
lulkuqen ta keni
në shtëpi.

Ajo ditë
është lot gëzimi,
lule blerimi
që hijeshon dhenë.

I madh, i vogël
ballëhapur
t'ia thot' këngës
në liri.

N JË N A TË

U përpoqa një natë
Sy, o biri im
të shkruaj një vjershë
ashtu pa fillim.

Ç'është, kjo që terri
më bën të trishtuar
e kur lind dielli
më bën të gjuar!

Dëgjoj çilsa, uri,
me grile rrëthuar
vuajtje masakrime
netët pa mbaruar.

Rreth e përqark meje
lodrat i zë gjumi
kërcet zjarri n'vatër,
fushës përshkon lumi.

Kështu pra një natë
pa gjumë në trishtim
u përpoqa të shkruaj
një vjershë pa mbarim.

A di gjë për luftën
Sy, o biri im,
fushës Vietnamit
që mbolli pik'llim!

Atje lodrat s'flinin,
n'roje babë e bir
dhe të dy mbaronin
trim, hero, martir!

Atje e kudo qoftë
jeta pa liri —
është e zezë, e rëndë
bir për çdo njeri...

Kështu, pra, një natë
u përpoqa të shkruaj
një vjershë pa fillim
një vjershë pa mbarim.

N A T È N

Natën... çdo gjë pushon
vetëm nëna,
vetëm nëna
fëmijën e përqafon.
Dhe këndon
dhe këndon:

Fli, bir i nënës, fli
syrin si ulli,
t'paça me laps e letër
e m'u bëfsh plak me mjekër.

Natën ... çdo gjë heshtur
vetëm lumi,
vetëm lumi
e mat kohën që kalon
dhe tregon
dhe tregon:

Ishte një herë një i ri
trim i rrallë qe besa
luftoi, luftoi për liri
katër vjet si vesa...

Natën çdo gjë pushon
vetëm hëna,
vetëm hëna
rretheqark lundron
dhe ëndërron
dhe ëndërron:

Krahëhapur mbi re
vocrrakët fluturojnë
në anije^t me vela
lundrojnë, lundrojnë...

TRIMAT E SREMIT

Ishte fillim i një stine...
Po gjëmon,
pëlcasin minat e Sremit.

Ishte mesi i një nate...
Po kërcet
në hapsirat e Sremit
Brigadë e Shtatë shqiptare
vret e pret.

Erdhi fundi i një lufte
ngadhnjyen trimat e Sremit.

FLORA BROVINA

VERMA EMRIN TIM

Nëse më njeh — e di emrin tim
ka emrin e fluturimit.

Nëse e di emrin tim, mos më thirr fluturim
Nëse më ke parë — e di kush jam,
i kam krihët e thëllëzës.

Nëse e di kush jam, mos më thërrit thëllëzë.

Nëse ke dëgjuar këngën time — e di si këndoja,
vëlla e kam bilbilin.

Nëse e di si këndoja, këngën mos ma ndal.

Nëse lotët i urren — e di se unë nuk qaj,
qyqen nuk e kam fis.

Nëse e di se nuk qaj, mos më thuaj se nuk ndjej.

NATA E KOBEVE

Atë natë edhe hëna qau
si nëna në zi,
atë natë vdiq Ganimeti ¹⁾
u fik një dashuri.

Atë natë shpendit iu këputën krahët,
atë natë pranvera mbaroi
e lulja u tha,
atë natë pikëllimi zëmrën e shpoi,
atë natë, o natë e kobeve:

Atë natë, por...
Ganimeti edhe tani jeton
në rininë time.

1) Vrarë nga fashistët.

P O R T R E T I

Liqen ngjyrash,
sa shumë ngjyra
ngjyrosi me të kuqe,
kjo të ngjan ty.
Sa shumë ngjyra!
Rruga jote e kuqe,
tërëjeta e kuqe,
edhe qelli më i bukur,
i kuq është.
Sa pikture e madhe, sa e kuqe!

V A L L J A

E di një valle, e di një valle të madhe,
do t'ju përshpëris të gjithëve,
e di një valle pa daulle e tupana,
pa dimia e mintana,
por të bukur.

E di një valle me hapa të lehtë,
dora-dorës, hapa-hapës dhe përpjetë;
e di një valle, me shoqet e mia
do ta hedhim të madhe

në ditën që do t'vij.

KUR UNË SHKRUAJ

Unë shkruaj poezi
në orë të vonë;
ti ndoshta gazetën shfleton
apo fle e qetë.

Unë shkruaj poezi
në një skutë, në shtëpi
ti ndoshta qan, dënes
a qëndis
pajën e nusërisë.

Unë shkruaj poezi dhe kam besim
që nesër
ndoshta edhe te ti
do të vijë vargu im.

MËNGJESI I QYTETIT TIM

Rrugët herët janë zgjuar,
qyteti s'bën zhurmë,
e heshtas i sodis hapat e ditës së re,
njerëzit ecin, ecin dikah
me përshëndetje dhe dëshira në gojë
për mirëmëngjes.

Hapat kërcasin në trotuaret e pastruara,
si çekana fabrikash si maqina shikrimi
dhe çdo gjë është përngut
dhe mëngjesi që ikën shpejt.

Rrugët herët janë zgjuar
bashkë me shitësin e gazetave
me bartësin e qumështit e lustraxhiun.
Kalimtarët ecin, ecin dikah
dhe një grua me fëmijë në krah...

NË PERON

...Askend s'e përcolla sonte
në trenin që nxitoi
në takim kah peroni tjetër.
Sonte pres ardhjen e trenit të mesnatës,
pres sonte unë, nuk përcjell
dhe eci...
e peroni kotet i lôdhur
nga pritjet dhe përcjelljet pambarim.
Eci e s'e lë të flejë
(le të më bëjë shoqëri).
Unë pres trenin e mbramë të mesnatës
në orën e madhe
akrepat akoma luajnë lotët e tyre
takohen e ndahen për t'u takuar.
Unë eci...
Një plak dremitet i lodhur,
pret edhe ai në këtë orë të vonë
nisjen e trenit të mesnatës
dhe eci...

K U K È L L Z A

Ti hesht belbëzimet e mia,
hapat e para, nisjet e para,
ëndërrat e saja të bardha,
oj kukëllëz,
ti hesht bëlbëzimet e mia
edhe atëherë kur shkoi fëmijëria,
lodër e fëmijërisë,
e imja kukëllëz
tani hesht
në krahët e mia
çupëz.

VOGËLUSHJA

Mos, mos qaj vogëlushe, ti
e dashur mos qaj,
sejeta ka dhe vaj
por ti... mos qaj.

M'i zgjat duart,
mbështetu në kraharorin tim
e me dënesje,
më jep tënden dhimbë.

E dashur mos qaj
mos vogëlushja ime.
E, nëse në zemër ke shumë vaj,
më lejo dhe mua të qaj.

SHOQJA IME

Të takova në kalim
duke ecur me nxitim,
e habitur se s'të pashë,
shoqe e klasës sime, thashë!

Përdore një vogëlushe mbani,
shoqe e klasës ti je nënë?!
Vogëlushi qesh me ëmbëlsi,
unë të shikoj, të kam lakmi.

UNË DHE NJERËZIT

**Unë eci
e rrëth meje
njerëzit
ecin, ndalen, shkojnë.**

**Unë eci,
njerëzit ecin ngadalë,
me shpejtësi
e në mua qetësi.**

**Ata ecin
e askush nuk di
se jam vetëm,
se kam zbrazëti...**

KUR BIE SHI

Kur bie shi pullazet lahen,
kur bie shi strehët lotojnë,
rrugët bëhen lumënë
e në mua vërshon malli.

KOHA QË MË IKËN

Pse je kaq e lazduar dhe nget si e marra,
e pyeta një ditë duke i folur në kalim.
Ajo më hipi në buzë dhe nuk m'u përgjegj.
Ndalu! i thashë që të mundem të të shoh.
Ajo hipi në shikimin tim dhe u bë mjegull.
Pse je kaq e lazduar, nget e më ikën?
Ajo hipi në hapin tim dhe nuk m'u përgjegj.

Kush ngiste më shpejt ajo apo unë?

BEDRI HYSA

KALI INTROJËS

N'galop kozmik bredh. i Trojës kali
me t'tetat fluturimthi n'për meridiane,
ndër frerë i maskuar e mban kanibali
shkëndia duke nxjerrë në tokë prej çdo ane.

Njerëz të mi, nxirrni bedenat e moçëm plot gjak,
për mirëseardhje t'ia shtrojmë atij n'udhë
e për zemra të mbahemi pa as një lak:
të shihni n'theqafje se ç'ka për t'u hudhë.

NË TOKËN TIME...

Në tokën,
nën këmbë të mia
e kam edhe zemrën.

Qielli mbi kokën time,
gjer në kupë është imi.

Ujji rrëth meje
është kënga e jetës sime

Tokën
qiellin
ujin
i barta në trashëgim.

Tani
përse kjo blozë?

T I M B I R I

Yjt për ty do t'i rreshtoja për çdo hap,
ecjen tënde e ndjej nëpër krahërën,
me zemrën time të kapur vrap,
ec drejt njeriut të thjeshtë madhështor.

F S H A T A R I I M

Fshatari im ka kësulën e bardhë,
fjalën e urtë dhe shumë të rrallë.

Zemrën si kësula e ka, të gjerë sa deti,
me fuqi vullkani që fle në veti.

Nga brendi e thellë rrjedhin melodi,
që krijojnë simfoni,
nga ky shpirt i rrallë, nga kjo bukuri...

HEROIZËM

**Heroizëm është
edhe rasti i dhënë
por vështirë është, vështirë
miku im
të jesh hero
gjatë tërë shekullit tënd
madje
edhe pas tij.**

LARGÉSI E AFÉRT

Largësi e afërt,
afërsi e largët,
në mes
zjarri brambull,
i madh sa një diell
e nga flakadani
në galaksion
do fluturojnë pëllumbat e kuq
të zjarrit,
do shtohen yjet në qiell.

THE H. B. GOOD

John H. Good
President of the
Good Co.
Hudson, Wis.
H. C. Good, Pres.
H. C. Good, Pres.
H. C. Good, Pres.
H. C. Good, Pres.
H. C. Good, Pres.

P A S Q Y R A E L E N D E S

MAZLLUM SANEJA

Heshtja e një kohe	5
Ti, kurrë	6
Granada	7
Këlthite	8
Mallëngjimi	9
Thjeshtësia e pashkruar	10
Etje	11

TAHIR FONIQI

Kjo është buka jonë	15
Shpeshherë	16
Një fshatar duke lexuar një libër	17
Lagjia	18

MEHMEDALI HOXHA

Një brez livadh	21
Kolona partizane	23
Vendlindja ime	25
Një Majit	26
Një natë	28
Natën	30
Trimat e Sremit	32

FLORA BROVINA

Verma emrin tim	11
Nata e kobeve	11
Portreti	11
Vallja	11
Kur unë shkruaj	11
Mëngjesi i qytetit tim	11
Në peron	11
Kukëllza	11
Vogëlushja	11
Shoqja ime	11
Unë dhe njerëzit	11
Kur bie shi	11
Koha që më ikën	11

BEDRI HYSA

Kali i Trojës	11
Në tokën time	11
Tim biri	11
Fshatari im	11
Heroizëm	11
Largësi e afërt	11